**AKT- THEMELIMI**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"AL RAWAA INVESTMENT COMPANY"**
**SH.P.K.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"AL RAWAA INVESTMENT COMPANY" Sh.p.k.**

1- **ALI ABDO HAMOUD HAMZAH** atesia **ABDO** , shtetas YEMEN , lindur me 01.01.1979 ne IBB-YEM, identifikohet nepermjet pasaportes 07792120.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë **"AL RAWAA INVESTMENT COMPANY"** Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1**
**FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise **"AL RAWAA INVESTMENT COMPANY" Sh.p.k.**,

**NENI 2**
**BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI3**
**SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "DESHMORET" Lagja nr. 4,Godina me xhama ,afer karburant ALPET ,kati i 3 ,Zyra 54,Nr. Pronesie 6/62,zona kadestrale 8514, Durres, Shqiperi.
Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.
Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron



EVA DOKAJ

veprimtarine shoqëria.

## NENI 4
## KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

## NENI 5
## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria "**AL RAWAA INVESTMENT COMPANY**" Sh.p.k. është e organizuar në formën e një shoqërie e cila ka si objektiv punime në fushën e ndërtimit.

## NENI 6
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 LEKE (Njeqind mije Leke), i ndarë në 1 pjesë .Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

| | | |
|---|---|---|
| **1. ALI ABDO HAMOUD HAMZAH** | **100,00%** | **100.000,00 LEKE** |

Kapitali themeltar i shoqërise është shlyer tërësisht dhe depozituar ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

## NENI 7
## AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

## NENI 8
## ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "**AL RAWAA INVESTMENT COMPANY**" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administratoret e shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjeçare

jane emeruar:

**1. ALI ABDO HAMOUD HAMZAH**

**2.EVA QOKAJ**

Te cilet mund te ushtrojne kompetencat e tyre se bashku ,ose edhe vec e vec .

## NENI 9
## DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tiranë.

Ky akt themelim është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë në gjuhën shqipe, duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

**Tirane 24/11/2020**

**ASAMBLEJA E ORTAKEVE TE SHOQERISE**
**"AL RAWAA INVESTMENT COMPANY"**
**SH.P.K.**

**ALI ABDO HAMOUD HAMZAH**

علي حمزة



EVA QOKAJ